



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:212640
Datë: 29.11.2024
Numri i dokumentit: 06523630

C.nr.685/2017

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË/Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë me gjyqtaren Vlerona Maliqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. S. nga M., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Zenel Ademi, avokat nga Mitrovica, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, me objekt kontesti zhdëmtim material, në seancën e datës 25.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit A. S. nga M., e ushtruar kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, me objekt kontesti zhdëmtim material, në këtë çështje juridike kontestimore.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi A. S. nga M. pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, me objekt kontesti zhdëmtim material.

Lidhur me këtë çështje, gjykata më datë ... ka caktuar seancën e shqyrtimit përgatitor, në të cilën nuk kanë prezentuar asnjëra nga palët ndërgjyqëse, ndërsa nga fletëkthesa për dorëzim personal,

rezulton se përfaqësuesi i autorizuar i paditësve është ftuar me rregull për këtë seancë gjyqësore, respektivisht ftesën për seancë e ka pranuar më datë, mirëpo në seancë nuk ka prezentuar dhe mosprezencën nuk e ka arsyetuar, andaj gjykata konform dispozitës së nenit 409 par.1 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet.”*, vendosi si në pikën I të dispozitivit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 të LPK-së.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.685/2017 më datë 25.11.2024

G j y q t a r j a

Vlerona Maliqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimi të të njëjtit, Gykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj gjykate.